



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 03.06.2022

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]: 03.06.2022

Drejtuar: *ALBTELECOM*

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-27998-05-09-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Shërbim mobile]:

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] , 16.05.2022, nr.63

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Vodafone Albania
Emri i plotë i shoqërisë

K11715005L
Numri i NIPT-t

Vlera 1.389.012 (një milionë e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH

2.ALBTELECOM

J61824053N

Vlera 1,647,505.08 lekë (një milionë e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e pesë pikë zero tetë) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1 Vodafone Albania

K11715005L

arsyet e mëposhtme

Oferta e OE është anomalisht e ulët. KVO nuk është i bindur për elementët që e bëjnë ofertën e OE të jetë anomalisht e ulët, pasi nuk ka sqaruar elementet konkrete favorizues që e bejne ofertën e tij me vlerë me të ulët se pragu ligjor. .

Në nenin 93 të LPP parashikohet:

1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Barra e provës në rastin e ofertave anomalisht të ulëta i bie operatorit ekonomik, i cili duhet t'i japë garanci dhe bindje AK se pavarësisht kosots së ulët ekonomike do të kryejë shërbim cilësor dhe sipas kërkesave të AK. OE duhet të kishte paraqitur të detajuar anën ekonomike të shërbimit të ofruar, të paraqiste zgjidhjet teknike të ofruara, si dhe ndonjë kusht favorizues që mund të ketë OE në kryerjen e shërbimit. OE nuk ka provuar asnjë prej situatave të mësipërme. Gjithashtu në argumentimin që kë asjellë OE nuk ka përfshirë në analizë kostot për njësi/elementë të paketës dhe kërkesës për shërbim. OE ka vendosur kosot të përgjithshme si koston e operimit në rrjet dhe kostot e interkoniksionit, të cilat nuk sqarojnë detajet e ofertës ekonomike.

Akoma me tej OE te sqarimet per oferten anomalisht te ulet ka vendosur nje vlere totale qe nuk perputhet me vleren e ofertuar per kete procedure prokurimi (edhe pas korrigjimit te gabimeve aritmetike), duke mos qene i qarte per vleren ekonomike me te cilen ka dashur te ofertoje.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [ALBTELCOM, *Tiranë Rr. "Muhedin Llagami", kompleksi Square 21*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,647,505.08 lekë (një milionë e gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e pesë pikë zero tetë) lekë pa TVSH [*shuma përkatëse e shprehur me fjalë dhe shifra*] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

DREJTOR

Skënder Brataj